

### **Përshkrimi i kursit**

Një ndër sfidat kryesore me të cilën përballen sot shoqëritë ujësjellës kanalizime është ajo e përmirësimit të performancës. Kursi synon ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve për ta përdorur benchmarking para së gjithash si një mjet të brendshëm të përmirësimit të performancës. Kursi do të trajtojë çështje të cilat kanë të bëjnë me programin e përmirësimit të performancës, parakushtet për një proces të suksesshëm benchmarking, ndërlidhjen e aktiviteteve të benchmarking me objektivat strategjike, grumbullimin dhe vlerësimin e të dhënave si dhe identifikimin dhe përzgjedhjen e aktiviteteve parësore për përmirësimin e performancës.

Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuri dhe aftësi të nevojshme për të përdorur informacionin e grumbulluar dhe përpunuar gjatë procesit të benchmarking për përmirësimin e performancës së shoqërisë së tyre.



### **Kush duhet të marrë pjesë**

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për manaxherët kryesorë dhe specialistët e raportimit.

### **Objektivat e kursit të trajnimit**

Në fund të këtij kursi trajnimi ju do të jeni të aftë të:

- Kuptoni çështjet që duhet të shqyrtohen gjatë kalimit nga objektivat strategjike në përmirësimin e performancës;

- Hartoni një program të plotë planesh veprimi për përmirësimin e performancës;
- Kuptoni rëndësinë e benchmarking si një mjet për përmirësimin e performancës;
- Kuptoni rëndësinë e ndërlidhjes së aktiviteteve të benchmarking me objektivat strategjike;
- Shpjegoni rëndësinë e vlerësimit të performancës;
- Dalloni cilësinë e informacionit gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave;
- Kuptoni domosdoshmërinë e verifikimit të të dhënave;
- Kuptoni rëndësinë e kryerjes së një analize të brendshme;
- Analizoni prirjen për indikatorë të caktuar;
- Identifikoni aktivitetet për përmirësimin e performancës;
- Përzgjidhni aktivitetet parësore për përmirësimin e performancës.

### **Metoda e trajnimit**

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë edhe raste konkrete studimore.

### **Materialet e kursit**

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Manaxhimi i Performancës nëpërmjet Benchmarking". Përpos kësaj, ju do të pajiseni me certifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

### **Tarifa e regjistrimit**

Anëtarët e SHUKALB: 22,000 lekë për person  
Jo-anëtarët: 25,000 lekë për person.

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.